

**UDHËZUESI PËR TË
DREJTAT E NJERIUT
NDAJ MJEDISIT NË
KOSOVË**

SHTATOR 2020



MA NDRY SHE

UDHËZUESI PËR TË DREJTAT E NJERIUT NDAJ MJEDISIT NË KOSOVË

Autore: Klodeta Krasniqi

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren
&
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1
Nr.5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky dokument është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" që implementohet nga Community Development Fund – CDF. Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



Indeksi i fotografive:

CORNU Th. Col du Lautaret, France (fotografi), Unsplash, 2019, edituar nga EC Ma Ndryshe (faqe 5)

Hardy, E. Pa Titull (fotografi), Mayan Handball Court, 2018, edituar nga EC Ma Ndryshe (faqe 12)

Åström M. Svedmyra (fotografi), Nyligen, 2016, edituar nga EC Ma Ndryshe (faqe 19)

Baltermants D. Pa Titull (fotografi), Moscow, USSR, 1960-ta, edituar nga EC Ma Ndryshe (faqe 23)

Hardy B. A group of men sit around chatting in the streets of Londonderry. (fotografi), Northern Ireland. 1955, edituar nga EC Ma Ndryshe (faqe 27)

Salomon E. May It Please the Court (fotografi), Fortune Magazine, 1932, edituar nga EC Ma Ndryshe (faqe 29)

PËRMBAJTJA

HYRJA	1
DEFINICIONET	3
E DREJTA NDAJ JETËS DHE MJEDISIT	5
E DREJTA PËR JETË PRIVATE DHE FAMILJARE	12
E DREJTA NDAJ PRONËS	19
E DREJTA E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT	23
E DREJTA E PJESËMARRJES NË VENDIMMARRJE	27
E DREJTA E QASJES NË DREJTËSI DHE KOMPENSIM	29
PËR EC	33

Udhëzuesi për të drejtat e njeriut ndaj mjedisit në Kosovë është përmbledhje e dispozitave të përzgjedhura ligjore nga dokumente ligjore të cilat adresojnë të drejtat e qytetarëve të Kosovës në raport me mjedisin jetësor të tyre.

Ky dokument merr për bazë të drejtat e përcaktuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të cilat Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përmes praktikës gjyqësore ka vërtetuar se ndërlidhen me mjedisin jetësor. Nenet relevante nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut të cilat konsiderohen relevante janë

- e drejta për jetë** (neni 2),
- e drejta për respektim të jetës private, familjare dhe banimit** (neni 8),
- e drejta e gjykimit të drejtë dhe qasjes në gjykatë** (neni 6),
- e drejta e pranimit dhe shpërndarjes së informatës dhe ideve** (neni 10),
- e drejta në kompensim efektiv** (neni 13) dhe
- e drejta e gëzimit të pronës në qetësi** (neni 1 i protokollit nr.1).

Udhëzuesi bazohet në katërmbëdhjetë (14) dokumente ligjore, përfshirë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Kodi penal i Republikës së Kosovës
- Ligji nr.03/l-025 për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji nr.03/l-233 ligjin për mbrojtjen e natyrës
- Ligji nr.02/l-102 për mbrojtjen nga zhurma
- Ligji nr.03/l-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji nr.04/l-147 për ujërat e Kosovës
- Ligji nr.03/l-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore
- Ligji nr.04/l-174 për planifikimin hapësinor
- Ligji nr.03/l-230 për vlerësimin strategjik mjedisor
- Ligji nr.03/l-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Ligji nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji nr.04/l-197 për kimikate
- Ligji nr.03/l-119 për produktet biocide

Ky dokument ofron një pasqyrë të përgjithshme të të drejtave, obligimeve dhe kufizimeve të institucioneve publike dhe qytetarëve në raport me mjedisin, me referencë në nenet relevante për informata më të detajuara rreth pikave të renditura. Duke qenë se korniza ligjore për mbrojtjen e mjedisit në masë të madhe është përshtatur me direktivat e BE-së, mund të konkludojmë se ky udhëzues promovon parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut rreth çështjeve mjedisore.

Udhëzuesi është i organizuar në shtatë (7) kapituj.

01 Kapitulli i parë ofron **Definicionet** kryesore që kanë të bëjnë me mjedisin në mënyrë që të krijojnë një pasqyrë rreth klasifikimit të elementeve të ndryshme mjedisore që korniza ligjore bënë si dhe ndotjes së tij. Ndërsa 6 kapitujt vijues renditin dispozitat e përpunuara ligjore për lexim më të lehtë, të ndara sipas fushës tematike që ato adresojnë.

02 Kapitulli i dytë, gjegjësisht **E drejta ndaj jetës dhe mjedisit** elaboron të drejtën e garantuar për jetë dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore, përgjegjësitë e institucioneve të nivelit qendror dhe lokal në raport me mbrojtjen, zhvillimin dhe promovimin e mjedisit si dhe mekanizmat institucionale për ekzekutimin e detyrave përkatëse.

03 Kapitulli i tretë, **E drejta për jetë private dhe familjare** adreson mundësitë dhe kufizimet në raport me veprimet e individëve dhe operatorëve, në mënyrë që të sigurohet një mjedis i pastër, i përshtatshëm dhe i sigurtë për qytetarët. Për pikat e renditura në kuadër të këtij kapitulli ofrohet referencë e cila në mënyrë të detajuar elaboron masat ndëshkuese nëse individët apo operatorët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e ofruara.

04 Kapitulli i katërt, **E drejta ndaj pronës** elaboron të drejtat e pronarëve apo bartësve të së drejtës ndaj patundshmërive dhe kufizimet e tyre në gëzimin e pronës së tyre për qëllim të ndërhyrjeve në funksion të interesit madhor publik, të mbrojtjes dhe zhvillimit të zonave me karakter të veçantë mjedisor.

Kapitulli i pestë, **E drejta e informimit dhe komunikimit** rendit të drejtat e qytetarëve për qasje në dokumente publike përfshirë strategjitë, planet apo raportet rreth gjendjes së mjedisit; të drejtën e informimit në raste të rrezikut nga ndotja e mjedisit dhe masave që institucionet apo personat përgjegjës do të marrin për zvogëlimin e ndotjes së mjedisit si dhe informimi rreth ndërhyrjeve në lokalitetet e tyre që mund të kenëndikim në mjedis.

Kapitulli i gjashtë, **E drejta e pjesëmarrjes në vendimarrje** ofron pasqyrë të të drejtave që korniza ligjore garanton për pjesëmarrjen e publikut në procese të ndryshme të vendimarrjes rreth mjedisit duke përfshirë hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve dhe programeve që kanë karakter obligativ, licencimit të shërbimeve në të mirë të publikut, vlerësimeve dhe lejeve për ndërhyrje dhe veprimtari në zona me karakter të veçantë të mjedisit të cilat mund të kontribuojnë në ndotjen e tij.

Kapitulli i shtatë, **E drejta e qasjes në drejtësi** dhe kompenzim elaboron të drejtat e individëve të dëmtuar nga veprimet apo kufizimet e vendosura nga institucionet dhe operatorë ekonomik në gëzimin e ambientit të pastër apo shfrytëzimit të patundshmërive si dhe të drejtën e kompensimit për dëmin apo kufizimin e shkaktuar. Poashtu adreson të drejtën për t'u qasur në drejtësi në rast të privimit të ndonjë të drejte në kundërshtim me ligjin si dhe të drejtat etë akuzuarve të cilët kanë apo prezumohet se kanë kryer vepra penale si i përcakton ligji.

05

06

07

Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës

Mjedisi:

është rrethina natyrore: ajri, toka, uji, klima, flora dhe fauna, në tërësinë e ndërveprimit dhe trashëgimia kulturore si pjesë e rrethinës të cilën e ka krijuar njeriu;

Natyra:

e gjithë biosfera duke përfshirë komponentët e larmisë biologjike, vendbanimet, formacionet gjeologjike, mineralet dhe fosilet, si dhe fenomenet tjera fizike dhe gjeografike në tokë;

Rrjeti ekologjik:

sistem i zonave të rëndësishme ekologjike të lidhura ndërmjet veti, të cilat me shtrirjen e balancuar biogjeografike dukshëm kontribuojnë në ruajtjen e vendbanimeve, llojeve dhe larmisë biologjike të cilën e bëjnë zonat e rëndësishme ekologjike për Republikën e Kosovës dhe janë përfshirë në Rrjetin e Zonave të Rëndësishme Ekologjike të BE "NATURA 2000";

Vlera e mbrojtur e natyrës:

vlerë e natyrës e mbrojtur nga organi i përcaktuar me këtë Ligj dhe i regjistruar në Regjistrin e vlerave të mbrojtura të natyrës dhe ka të bëjë me zonat e mbrojtura si: rezervati strikt i natyrës, parku kombëtar, zona e veçantë, parku i natyrës, monumenti i natyrës, peizazhi i mbrojtur dhe monument i arkitekturës së parkut, llojet e mbrojtura të bimëve, kërpudhave dhe shtazëve përfshirë ekzemplarët e ngordhur të llojeve të egra të mbrojtura në bazë të këtij Ligji dhe akteve ndërkombëtare, pjesëve dhe derivateve të tyre si dhe mineraleve, fosileve dhe shtresimeve të mbrojtura;

Zonë e Veçantë e Mbrojtur:

zonën e shpallur sipas Direktivës së BE-së për zogjtë e egër, zonat më të përshtatshme për kah madhësia dhe numri për ruajtjen e llojeve të përcaktuara me ligj dhe për llojet që rregullisht migrojnë;

Zonë e Veçantë e Ruajtur:

zonën e rëndësishme për Komunitetin e shpallur përmes masave ligjore, administrative dhe/ose aktit të kontratës kur masat e ruajtjes së domosdoshme janë zbatuar për mirëmbajtjen ose restaurimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimit natyror dhe/ose popullacionit të llojit për të cilin zona është shpallur;

Ndotja e mjedisit:

është ndikimi i drejtpërdrejtë ose e tërthortë e materieve ndotëse apo i energjisë në mjedis, e shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut ose përmes proceseve natyrore që kanë pasoja të dëmshme në cilësinë e mjedisit dhe në shëndetin e njeriut;

Dëmtimi i mjedisit:

është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, zvogëlimi i llojllojshmërisë biologjike dhe peizazhore, të ekosistemeve natyrore, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë së jetës, të shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit dhe tokës, prej veprimtarive të njeriut ose fatkeqësive natyrore;

Degradimi i mjedisit:

është proces i cenimit të cilësisë së mjedisit i shkaktuar nga proceset natyrore dhe aktivitetet e njeriut;

Çrregullimi mjedisor:

ka të bëjë me ndotjen e mjedisit kur materiet ndotëse i tejkalojnë normat e përcaktuara me ligj;

Statusi i mjedisit të rrezikuar:

është gjendje mjedisore kur tejkalohet shkalla e ndotjes e përcaktuar në bazë të matjeve, hulumtimeve dhe vlerësimit të indikatorëve të gjendjes, në raport me normat e lejuara;

Emission:

konsiderohet shkarkimi i materieve ndotëse, i energjisë dhe zhurmës nga burimet individuale dhe difuzive në mjedis;

Publiku:

konsiderohet një ose më shumë persona juridik ose fizik, shoqatat e tyre, organizatat, apo grupimet;

02 E DREJTA NDAJ JETËS DHE MJEDISIT

- 1.** Çdo person gëzon të drejtën për jetë.
(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 25)
- 2.** Çdo qytetar i Kosovës gëzon të drejtën e shfrytëzimit të resurseve natyrore të Republikës së Kosovës, sipas kushteve të përcaktuara me ligjet në fuqi.
(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 112)
- 3.** E drejta për ujë të pijshëm është e drejtë elementare dhe e pa cnuar, dhe gëzohet sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Realizimi i së drejtës për ujë nuk guxon të shpie në pasoja negative për resurset ujore.
(Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 69 dhe 76)
- 4.** Institucionet e Kosovës, përmes kornizës ligjore dhe mekanizmave institucionale garantojnë mbrojtjen e pasurive natyrore si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike;
(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 122)
- 5.** Institucionet e Kosovës duhet të themelojnë të gjithë mekanizmat e nevojshëm institucional me përgjegjësi të përkatëse në funksion të mbrojtjes, promovimit dhe zhvillimit të

mjedisit, si përcaktohet me rregulloren përkatëse.

(Rregullore (QRK)-Nr. 05/2017 Për Organizimin E Brendshëm Dhe Sistematizimin E Vendeve Të Punës Të Ministrisë Së Mjedisit Dhe Planifikimit Hapësinor, Rregullore (QRK) Nr.37/2013 Për Organizimin E Brendshëm Dhe Sistematizimin E Vendeve Të Punës Në Ministrinë E Bujqësisë Pylltarisë Dhe Zhvillimit Rural)

Institucionet e Kosovës, në përputhje me ligjet e kësaj fushe, duhet të sigurojnë mbrojtjen e resurseve natyrore me mjete nga Buxheti i Kosovës. Kjo bëhet përmes (Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 9):

- a.** hartimi dhe zbatimit të Strategjisë, planeve dhe programeve mjedisore;
- b.** zbatimit të standardeve, dispozitave dhe rregulloreve për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve natyrore;
- c.** vlerësimeve përkatëse të planeve, programeve dhe projekteve për ndikimin në mjedis;
- d.** monitorimit të shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe gjendjes së mjedisit;
- e.** menaxhimin e lejeve dhe licencave për ndërhyrjet, veprimtaritë apo shëbimet që mund të kenë ndikim në mjedis.

7. Institucionet e Kosovës përcaktojnë zonat e mbrojtura të natyrës duke u bazuar në mendimin profesional rreth vlerave të natyrës që ato posedojnë. Përmes dokumenteve të planifikimit përcakton masat e mbrojtjes së zonave të mbrojtura të cilat kanë të bëjnë me ndalesat ose kufizimet e ndërhyrjeve në hapësirë si ndërtimi i objekteve të infrastrukturës, ndërtimi i objekteve të reja transite, komunale, energjetike, telekomunikacionit dhe rrugëve, mihja ose mbulimi i terrenit, mihja dhe nxjerrja e gurëve, mineraleve, shtresimeve ose fosileve, deponimi i mbeturinave dhe lëshimi i ujërave të ndotura, ndryshimi i regjimit të ujërave, evitimi i përmytjeve, përdorimi i të mirave të natyrës për qëllime ekonomike, kryerja e veprimtarive përmirësuese, mënjanimi i mureve të gjalla dhe përbërësve tjerë të natyrës, mbjellja e monokulturave, grumbullimi i kërpudhave, bimëve dhe pjesëve të tyre, shqetësimi, vrasja ose kapja e shtazëve, gjuetia, peshkimi, veprimtaritë rekreative - sportive, vendosja e reklamave dhe shenjave të tjera, vizita dhe shikimi si dhe aktivitetet tjera të cilat mund ta rrezikojnë vlerën e mbrojtur të natyrës;

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 20 dhe 74)

8. Institucionet e Kosovës duhet të mbrojnë ujërat nga veprimet e dëmshme, erozioni dhe veprime të tjera të dëmshme. Për sipërfaqet ujore që shtrihen në kuadër të zonave urbane përgjegjëse është niveli lokal ndërsa sa i përket hapësirës së pellgut lumor, rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës mbrojtëse në shtretërit e lumenjve, përfshirë edhe pritrat malore, muret mbrojtëse dhe objektet tjera mbrojtëse është niveli qendror. (Ligji Nr. 04/L- 147 për Ujërat e Kosovës, neni 46)

Institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë kushtet për inkurajimin, edukimin dhe arsimimin lidhur me mbrojtjen e natyrës përmes medimeve, ligjëratave dhe veprimtarisë botuese si dhe të informojnë për vlerat e natyrës më qëllim të vizitës së tyre, për qëllime arsimore dhe rekreative. Me qëllim të promovimit të mbrojtjes së natyrës për çdo vjet shënohet Dita e mbrojtjes së natyrës, gjatë së cilës organizohen aktivitete edukative, arsimore, rekreative, profesionale etj. Dita e mbrojtjes së natyrës shënohet çdo vjet me 22 maj në Ditën ndërkombëtare të larmisë biologjike. (Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 154)

Gjatë marrjes së vendimeve rreth aktiviteteve zhvillimore institucionet publike duhet të marrin parasysh ndikimin në mjedisin jetësor; (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 52)

Qeveria dhe komunat duhet të hartojnë strategjitë, planet apo programet mjedisore të cilat shërbejnë për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.

Për planifikimin e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor, duke përfshirë shfrytëzimin sa më efikas të resurseve natyrore në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës shoqëror, institucionet e Kosovës duhet të hartojnë dokumentet si në vijim: (Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, Neni 12 -17)

- a. Plani Hapësinor i Kosovës;
- b. Harta Zonale e Kosovës;
- c. Planet Hapësinore për Zona të Veçanta;
- d. Plani Zhvillimor Komunal;
- e. Harta Zonale e Komunës;
- f. Planet Rregulluese të Hollësishme.

- 13.** Për mbrojtjen nga zhurma, institucionet e Kosovës duhet të hartojnë dokumentet si në vijim:
(Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, neni 9):
- Hartën strategjike të zhurmës;
 - Planin e veprimit
- 14.** Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, institucionet e Kosovës duhet të hartojnë dokumentet si në vijim:
(Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 28):
- Strategjinë e cilësisë së ajrit;
 - Planin e veprimit për cilësinë e ajrit;
 - Planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit;
 - Raportet për zbatimin e planeve për cilësinë e ajrit;
- 15.** Për planifikimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e pellgjeve lumore, institucionet e Kosovës duhet të hartojnë dokumentet si në vijim, të cilat shqyrtohen çdo pesë vjet
(Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 46 dhe 84):
- Strategjinë shtetërore të ujërave;
 - Planet për menaxhimin e pellgjeve lumore.
- 16.** Për vlerësimin e efekteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të planeve dhe programeve në mjedis, hartuesit e këtyre dokumenteve duhet të zhvillojnë dhe të integrojnë në dokument rekomandimet e dala nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor.
(Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Neni 3)
- 17.** Për vlerësimin e efekteve të drejtpërdrejta apo të tërthorta që projektet publike apo private mund të kenë në njeriun, botën bimore dhe shtazore, tokën, ujin, ajrin, klimën dhe

peisazhin, të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore duhet të zhvillohet Vlerësimi i ndikimit në Mjedis (VNM). Ligjipërkatës përcakton në kuadër të shtojcave llojet e projekteve për të cilat nevojitet zhvillimi i VNM-së;
(Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, neni 3)

Për vlerësimin e besueshmërisë së zbatimit të planit, programit apo ndërhyrjes në zonën e rrjetit ekologjik ndikon në ruajtjen e zonës së rrjetit ekologjik duhet të zhvillohet Vlerësimi i pranueshmërisë për rrjetin ekologjik. Për ndërhyrjet për të cilat është i nevojshëm Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, vlerësimi i pranueshmërisë zhvillohet në kuadër të këtij procesi. Nëse gjatë shqyrtimit të pranueshmërisë së ndërhyrjes në zonën e rrjetit ekologjik vërtetohet se ndërhyrja e planifikuar ka ndikim të dëmshëm në rrjetë dhe nuk ka zgjidhje tjera të përshtatshme pa ndikim të dukshëm, ndërhyrja megjithatë mund të ndërmerret nëse mund të dëshmohet interesi madhor publik, duke përfshirë atë social dhe ekonomik. Në këtë rast Ministria përcakton kushtet e kompensimit me qëllim të ruajtjes së lidhshmërisë së përgjithshme të rrjetit ekologjik. Përyjashtimisht, nëse në zonën e rrjetit ekologjik gjendet tipi i vendbanimit dhe/ose lloji nga regjistri i vendbanimeve të rëndësishme dhe llojeve veçanërisht të rrezikuara, ndërhyrja me interes madhor publik lejohet vetëm me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të popullatës dhe sigurinë publike, në vendosjen e kushteve dukshëm më të volitshme mjedisore, ose arsyt tjera të interesit publik madhor për të cilat vendimin e nxjerr Qeveria me pjesëmarrjen e publikut
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 33, 34 dhe 38)

- 19.** Për të zbutur rrezikun në rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor apo ndonjë ndodhie që rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, institucionet hartojnë planin e intervenimit;
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 35)
- 20.** Për rehabilitimin e mjedisit në rastet e çrregullimeve mjedisore të shkaktuara nga veprimtari të autoriteteve publike apo personave juridik apo fizik, hartohet plani për masat e rehabilitimit të mjedisit sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Ky plan duhet të hartohet nga subjekti që ka shkaktuar çrregullimin mjedisor. Në rastet kur personi juridik apo fizik nuk është identifikuar, hartimi i planit për masat e rehabilitimit të mjedisit duhet të hartohet dhe zbatohet nga institucioni përkatës.
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 34)
- 21.** Për të zvogëluar ndotjen dhe përmirësuar cilësinë e ajrit, Ministria përcakton masat për rregullimin, ndaljen dhe kufizimin e shkarkimit në ajër nga burimet e ndotjes; autoriteti lokal përcakton masat për rregullimin, ndaljen dhe kufizimin e burimeve të emisioneve të ndotësve në ajër ndërsa operatorët duhet t'i zhvillojnë dhe aplikojnë masa preventive;
(Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 24)
- 22.** Për normalizimin e gjendjes mjedisore, përfshirë cilësinë e ajrit në raste të tejkalimit të theksuar të vlerave kufitare të ndotësve, autoritetet lokale në bashkëpunim me Ministrinë, por poashtu edhe operatorët e burimeve të ndotjes duhet të ndërmarrin masat e nevojshme emergjente;
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 38; Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 9 dhe 24)
- 23.** Çdo person juridik apo fizik që dëshiron t'i shfrytëzoj resurset natyrore apo të zhvillojë veprimtari të cilat mund të ndikojnë në ndotjen e mjedisit duhet të pajiset me leje adekuate nga Institucionet përkatëse. Lejet sipas qëllimit të shfrytëzimit janë:
- a.** Pëlqimi mjedisor, i cili ofrohet në rastin kur vlerësimi i ndikimit në mjedis përfundon se projekti publik apo privat ka ndikim të moderuar në mjedis, brenda kushteve të përcaktuara me politikat publike për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit për qëllim të marrjes së lejes për ndërtim;
(Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)
- b.** Leja e integruar mjedisore, e cila autorizon me shkrim operimin e veprimtarive që mund të kenë ndikim në mjedis, me të cilën sigurohet parandalimi dhe kontrolli i ndotjes së mjedisit sipas standardeve të larta të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut;
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 30)
- c.** Leja mjedisore, e cila lëshohet për ndërtesat apo pajisjet të cilat kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis para funksionalizimit të tyre;
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 31)
- d.** Leja mjedisore komunale, e cila lëshohet për të gjitha llojet e aktiviteteve apo projekteve të cilat nuk trajtohen me lejet e tjera të renditura në kuadër të kësaj pike por që mund të shkaktojnë çrregullime në mjedis;
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 32)
- e.** Autorizimi mjedisor, e cila lëshohet për lloje të caktuara të aktiviteteve apo projekteve që përcaktohen nga niveli qendror, e që nuk kërkohet pëlqimi mjedisor, leja e integruar mjedisore apo leja mjedisore;
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 33)

f. Leja ujore, e cila lëshohet për nxjerrje të ujit për konsum të përgjithshëm; shkarkim të ujërave të ndotura; ndërtimin, rindërtimin ose demolimin e objekteve dhe pajisjeve që ndikojnë në regjimin ujqor; aktivitetet e minierave dhe punimet gjeologjike të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave; për hulumtime hidrogjeologjike dhe grumbullimin e të dhënave; eksploatimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilit; përdorimi i ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale; dhe aktivitete tjera që mund të ndikojnë në regjimin ujqor. Leja ujore nuk është e nevojshme për shfrytëzimin e puseve, burimeve, cisternave dhe objekteve të ngjashme për furnizimin e një amvisërie me ujë të pijshëm, fikjen e zjarreve dhe ndërmarrjen e masave urgjente sanitare dhe masave tjera në rast të rrezikut të përgjithshëm. Nëse ka më tepër se një kërkesë për shfrytëzimin e ujit nga një trup i njëjtë ujqor, kërkesat prioritizohen sipas rradhës (1) furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm, përgatitjen e ushqimit dhe ujë për pije për bagëtinë, (2) nevojat e bujqësisë, (3) nevojat e industrisë dhe për nevoja ekonomike, (4) nevojat e prodhimit të energjisë elektrike dhe nevojat tjera motorike, (5) nevojat e sektorit jo konsumues – rekreacion, (6) nevojat e mbushjes së ujit nëpër shishe- nevoja komerciale. Leja ujore lëshohet me afat kohor të caktuar, varësisht nga lloji i objektit dhe pajisjeve si dhe qëllimit të shfrytëzimit të ujit, por jo më gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vjet, përveç lejes për nxjerrjen e rërës, zhavorrit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet e trupave ujqore sipërfaqësore, që lëshohet me kohëzgjatje vetëm një (1) vit me mundësi vazhdimi varësisht nga prurjet e aluvionit në trupin ujqor. Në rastin e dhënies së lejes ujore për nevoja energjetike afati i lejes mund të

jetë deri në dyzet (40) vjet. Leja Ujqore rishqytohë së paku në çdo pesë (5) vjet

(Ligji Nr. 04/L-147 për Ujqërat e Kosovës, neni 27 dhe 28)

g. Leja për produktet biocide, e cila lëshohet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve biocide;

(Ligji Nr. 03/L-119 për Produktet Biocide, neni 15)

h. Leja për grumbullimin e bimëve, kërpudhave dhe pjesëve të tyre si dhe kapja ose vrasja e shtazëve të cilat i përkasin kategorisë të llojeve të egra të mbrojtura për qëllim të përpunimit, tregtisë dhe qarkullimit tjetër;

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 90)

i. Leja për shfrytëzimin e mineraleve, shtresave dhe fosileve;

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 137)

Institucionet e Kosovës në nivelin qendror në kuadër të ministrisë përkatëse duhet të themelojnë Inspektoriatin Mjedisor të Ministrisë, të cilët zbatojnë mbikëqyrjen inspektuese të mjedisit. Poashtu, në kuadër të nivelit lokal Komunitat duhet të angazhojnë personat përgjegjës për mbikëqyrjen inspektive të mjedisit në kuadër të territorit të Komunës përkatëse të cilët mund të autorizohen nga ministria për kryerjen e detyrave të tjera;

(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 81)

Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, inspektori për mbrojtjen e mjedisit mbikëqyr:

-zbatimin e standardeve të kualitetit për pjesët përbërëse të mjedisit;

- zbatimim e standardeve teknike për mbrojtjen e mjedisit;
 - zbatimim e monitorimit të gjendjes së mjedisit;
 - zbatimim e matjes së emisionit dhe imisionit dhe mbajtjen e evidencës për to;
 - zbatimim e masave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me programin për mbrojtjen e mjedisit;
 - zbatimim e masave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me planin për intervenim;
 - zbatimim e kushteve të përcaktuara në pëlqime, autorizime dhe leje të lëshuara në bazë të ligjit;
 - zbatimim e planeve për sanim, rehabilitim dhe intervenim si dhe përcjelljen dhe realizimin e tyre;
 - mënyrën dhe kushtet e punës, përgatitjen teknike të personave të regjistruar ose të autorizuar për kryerjen e punëve për mbrojtjen e mjedisit;
 - mënyrën e udhëheqjes të kadastrit të ndotësve dhe evidencës për mjedis;
 - shfrytëzimin e mjeteve të destinuara për ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit;
 - zbatimim e akteve ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së mjedisit;
- (Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 83)

- 26.** Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese për mbrojtjen nga zhurma, inspektori për mbrojtjen e mjedisit mund:
- a.** Të urdhëroj personat juridik ose fizik të cilët e përdorin burimin e zhurmës në mjedise ku njerëzit banojnë ose jetojnë, që të bëjnë matjen e nivelit të zhurmës;
 - b.** Të urdhëroj ndërmarrjen e masave nga rregullativa e caktuar mbi mbrojtjen nga zhurma;
 - c.** Të ndaloj përdorimin e ndërtesës së ndërtuar ose të projektuar, nëse nuk janë ndërmarrë masa për mbrojtjen

zhurma, deri sa këto masa nuk aplikohen;

d. Të ndaloj përdorimin e burimit të zhurmës deri sa nuk ndërmerren masa për mbrojtje nga zhurma;

e. Të ndaloj kryerjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve të tjera të cilat për arsye të zhurmës pengojnë pushimin dhe qetësinë e natës, nëse kjo nuk është e mundur të pengohet me masa nga pika (d) e këtij neni;

f. Të ndaloj përdorimin e makinave, mjeteve transportuese, pajisjeve dhe aparateve të cilat nuk kanë evidencë për forcën e zhurmës që emitohet në kushte të caktuara të përdorimit;

g. Të ndaloj kryerjen e veprimtarisë ose aktiviteteve të tjera, nëse e njëjta fillon punën pa një vendim të organit kompetent në të cilin përcaktohen masat mbi mbrojtjen nga zhurma.

(Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, neni 24)

Inspektori është i detyruar të hartoj **27.** raport mbi kryerjen e mbikëqyrjes, gjendjen e konstatuar, masat dhe veprimet e ndërmarra, gjegjësisht të urdhëruara. Një kopje të raportit ia dorëzon personit të i cili është bërë mbikëqyrja inspektuese. Kur është e nevojshme të shmanget rreziku i drejtpërdrejtë për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe llojllojshmërisë biologjike inspektori mund të shqiptojë vendim me gojë. Vendimi me gojë shkruhet në procesverbal me shenjën se vendimi në formë të shkruar duhet ti dërgohet palës në afat prej tetë ditë.

(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 84 dhe 88)

28. Menaxhimi i mbeturinave bëhet nga persona të licencuar nga Ministria, që mund të jenë institucionet, kompanitë publike apo private të regjistruara sipas ligjit. Institucionet përkatëse duhet të sigurohen se menaxhimi i mbeturinave organizohet në atë mënyrë që mos të paraqiten dëme dhe rreziqe për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, në pajtim me ligjin. Nëse konsiderohet se metodat e trajtimit të mbeturinave që zbatohen nuk janë në harmoni me parimet e përcaktuara me ligj dhe në veçanti nëse nuk janë të pranueshme nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut, autoriteti kompetent do të refuzon lëshimin e licencës. Nëse në rastet e veprimt të forcës madhore personi i licencuar nuk do të jetë në gjendje të menaxhoj mbeturinat sipas kushteve të përcaktuara në licencë, është i detyruar të njoftoj Ministrinë. Në rast të mungesës apo tejkalimit të licencës së lëshuar nga ministria, tejkalimit apo mos përfilljes së kushteve të përcaktuara me ligjin për trajtimin e mbeturinave sipas llojit të caktuar, pengimin e inspektorëve që të ekzekutojnë detyrat sipas kompetencave të përcaktuara me ligj apo mbajtjes së evidencës për transport të mbeturinave, etj dënohen. (Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, neni 22, 55, 70 dhe 71)

29. Mjetet e nevojshme për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit sigurohen nga Buxheti i Kosovës. Në rastet kur ndotësi është person juridik apo fizik, ai duhet t'i bartë shpenzimet për vlerësimin e dëmit dhe mënjanimin e tij duke përfshirë shpenzimet e intervenimit urgjent për kufizimin dhe parandalimin e efekteve të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; shpenzimet e sanimit, krijimit të gjendjes së re ose rikthimin në gjendjen e mëparshme të mjedisit, si dhe monitorimit të efekteve të sanimit dhe efekteve të dëmit të shkaktuar në mjedis; (Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 69)

03 E DREJTA PËR JETË PRIVATE DHE FAMILJARE



1. Qytetarët e Republikës së Kosovës gëzojnë të drejtën e garantuar për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit;
(Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 1)

2. Çdo person ka të drejtë ndaj pasurive të përbashkëta si ajri dhe uji, dhe secili mund t'i shfrytëzoj brenda kufizimeve të përcaktuara me ligjet në fuqi.
(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Neni 12)

3. Çdo person juridik dhe fizik është përgjegjës për natyrën dhe biodiversitetin, mjedisin jetësor dhe trashëgiminë kombëtare;
(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 52)

4. Çdo person juridik dhe fizik mund të vizitoj dhe shikoj zonat e mbrojtura dhe vlerat e tjera të mbrojtura të natyrës, me përjashtim të rasteve kur një veprim i tillë mund të shkaktoj kërcënim për ruajtjen e tyre.
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, neni 129)

5. Çdo person juridik dhe fizik i cili i shfrytëzon resurset natyrore, është i detyruar që gjatë kryerjes së punëve dhe zhvillimit të aktiviteteve, si dhe pas përfundimit të këtyre aktiviteteve, të planifikojë dhe të zbatojë masat me të

cilat duhet të parandalojë ndotjen e mjedisit. Secili që dëmton mjedisin, është i detyruar të bëjë sanimin e mjedisit të dëmtuar, në përputhje me këtë ligj dhe ligjet tjera.

(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 11)

Çdo person juridik dhe fizik, duhet ta ruaj cilësinë e ajrit, ta mbrojë atë nga ndotjet e shkaktuara gjatë veprimtarisë që ushtrohen në territorin e Republikës së Kosovës dhe detyrohet të monitoroj, minimizoj emisionin e ndotësve dhe kundërmimeve, dhe të mos tejkaloj vlerat kufitare të emisionit.
(Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 8)

Ndalohet ndotja e ujit me materie të dëmshme të cilin njerëzit e përdorin si ujë të pijshëm, që mund të rezultoj me lëndime të lehta apo të rënda të shëndetit, apo vdekjen e një apo më shumë personave.
(Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 264)

Ndalohet hedhja, trajtimi, depozitimi, transportimi, eksportimi ose importimi i substancave të rrezikshme apo mbeturinave që mund të shkaktojnë vdekjen ose lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm substancial material të cilësisë së ajrit, tokës, ujit, kafshëve, bimëve ose pasurisë.
(Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 339)

- 9.** Nuk lejohet ndërtimi apo instalimi i fabrikës që në kundërshtim me ligjin kryhen veprimtari të rrezikshme dhe me këtë rrezikon të shkaktojë vdekjen apo lëndimin e rëndë trupor të ndonjë personi, ndot mjedisin, ajrin, tokën apo ujin ose shkakton dëm në shumë prej pesëmijë (5.000) Euro apo më shumë të kafshëve, bimëve ose pasurisë.
(Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 340)
- 10.** Nuk lejohet aplikimi i teknologjisë që ndot mjedisin ose territorin në shkallë të madhe, që rezulton me asgjësimin e plotë ose të pjesërishëm të botës shtazore, bimore ose ndotjen në shkallë të madhe për të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar.
(Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 340)
- 11.** Nuk lejohet që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit apo ndonjë mjeti tjetër vdekjeprurës, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë lloj energjie tjetër, me ndonjë veprim tjetër të rrezikshëm apo mjete të rrezikshme të shkaktoj rrezik të madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror. Poashtu personat juridik dhe fizik duhet që të vendosin pajisjet për mbrojtjen nga rreziqet e renditura më lartë në mënyrë që të mënjanohet rreziku i madh për jetën e njerëzve apo dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet;
(Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 356)
- 12.** Çdo person i cili pa rrezikuar veten apo ndonjë person tjetër ka mundësi, duhet të ndërmer, parandaloj apo ta mos pengoj personin tjetër nga ndërmarrja e masave për evitimin e zjarrit, vërshimit, eksplozimit, fatkeqësisë në trafik apo të ndonjë rreziku tjetër për jetën ose sigurinë fizike të njerëzve apo të pasurisë në shkallë të madhe.
(Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 362)
- 13.** Nuk lejohet ndezja e zjarrit apo shkaktimi i shpërthimit me qëllim të dëmtimit të pasurisë së personit tjetër, dëmtimit apo asgjësimit të banesës së banuar ose veturës në shfrytëzim nga personi tjetër.
(Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 322)
- 14.** Nuk lejohet ndotja, degradimi ose shkatërrimi i ajrit, ujit apo tokës ose shfrytëzimi jashtë mase i burimeve natyrore që mund të rezultoj në dëmtimin e shëndetit të një numri të madh të njerëzve apo me asgjësimin e plotë ose të pjesërishëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm apo me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda, apo me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike, dëmtimit apo shkatërrimit të papërmirësueshëm të mjedisit ose me rrezikimin e pasurive të mbrojtura natyrore.
(Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 338)
- 15.** Nuk lejohet dëmtimi, shkatërrimi, heqja apo defunksionalizimi i objekteve apo pajisjeve për mbrojtjen e mjedisit që mund të rezultoj me ndotjen e ajrit, ujit apo tokës në shkallë të madhe apo territorit të gjerë, asgjësimin e plotë ose të pjesërishëm të botës shtazore, bimore ose ndotjen në shkallë të madhe të cilën nevojitet kohë e gjatë ose shpenzime të mëdha për ta sanuar.
(Kodi Penal i Republikës së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 341)

16. Nuk lejohet që në kundërshtim me ligjin dhe me përdorimin e materies së dëmshme të shkaktoj shkatërrimin e bimëve, pemëve ose vegjetacionit tjetër dhe me këtë shkakton dëm në vlerë materiale.

(Kodi Penal i Republikës së Kosovës
Kodi Nr. 06/L-074, neni 347)

17. Nuk lejohet që në kundërshtim me ligjin ose urdhërin e organit kompetent të bëhet prerja apo shkatërrimi i pyllit ose në ndonjë mënyrë tjetër shkretërimi i pyjeve, përfshirë këtu pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur ose në pyje të tjera me destinim të posaçëm, apo prerja e pyllit me qëllim të shitjes.

(Kodi Penal i Republikës së Kosovës
Kodi Nr. 06/L-074, neni 348)

18. Ndalohen veprimet të cilat mund të ndikojnë në shkatërrimin ose dëmtimin e dukshëm dhe të përhershëm të zonës së rëndësishme ekologjike.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 63)

19. Ndalohet shfrytëzimi i të mirave të natyrës në mënyrën e cila shkakton dëmtimin dhe humbjen e pjellshmërisë natyrore të tokës; dëmtimin e vlerave sipërfaqësore ose nëntokësore gjeologjike, hidrologjike dhe gjeomorfologjike; varfërimin e botës natyrore të bimëve, kërpudhave dhe shtazëve; zvogëlimin e larmisë biologjike dhe peizazhore; ndotjen e ujit dhe rrezikimin e shfrytëzimit të tij.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 123)

20. Në rezervatin strikt, parkun kombëtar, zonën e veçantë, parkun e natyrës, peizazhin e mbrojtur, dhe në monumentin e arkitekturës së parkut ndalohet të kryhen aktivitete nënujore pa lejen e Ministrisë, gjegjësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës; të ankerohen dhe/ose lidhen lundrat jashtë vendit të caktuar me plan hapësinor; peshkimi rekreativ pa leje ose në kundërshtim me kushtet e dhëna në leje; dëmtimi dhe/ose shkatërrimi i shenjës dhe/ose tabelës informuese; ndezja e zjarrit jashtë vendbanimeve dhe/ose vendeve që për këtë qëllim janë të shënuara dhe të caktuara; xhirimi ose fotografimi për qëllime komerciale pa lejen e Ministrisë, gjegjësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës; fluturimi me fluturake ultra të lehtë pa lejen e Ministrisë gjegjësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës; vendosja e pllakave informative, panove reklamuese ose tjera pa lejen e Ministrisë, gjegjësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës; vizita dhe/ose shikimi pa biletë kur ajo është e detyruar; hedhja e mbeturinave jashtë vendit të paraparë për këtë; larja jashtë vendeve të caktuara nga drejtoria e cila administron me zonën.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 75)

21. Ndalohet përdorimi i mjeteve për kapjen dhe vrasjen e llojeve të egra si dhe shfrytëzimi i të gjitha mjeteve të cilat mund të shkaktojnë zhdukjen lokale ose shqetësime serioze të popullacioneve të atyre llojeve;

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 95)

22. Ndalohet vjelja, mbledhja, shkatërrimi, prerja ose shkulja e bimëve dhe kërpudhave strikt të mbrojtura të cilat mbijnë vetë përfshirë ato që gjenden në parkun kombëtar, rezervatin strikt, si dhe në zonën e veçantë për shkak të të cilave zona është marr nën mbrojtje;
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 97)

23. Ndalohet që kafshët strikt të mbrojtura që lirshëm jetojnë në natyrë të merren nga natyra përfshirë ato që gjenden në parkun kombëtar, rezervatin strikt, si dhe në zonën e veçantë për shkak të të cilave zona është marr nën mbrojtje; të kapen dhe/ose vriten me qëllim; të dëmtohen dhe/ose shkatërrohen me qëllim format e zhvillimit, çerdhet ose strofkat, si dhe zonat e shumëzimit dhe pushimit të tyre; të shqetësohen me qëllim, posaçërisht gjatë kohës së shumëzimit, rritjes së të vegjëlve, migrimit dhe dimërimit, nëse shqetësimi do të jetë i rëndësishëm në raport me qëllimet e mbrojtjes; me qëllim të shkatërrohen dhe/ose të merren vezët nga natyra ose të mbahen vezët e zbrastë; të dëmtohen ose shkatërrohen zonat e tyre të shumëzimit ose pushimit; të fshihen, mbahen, kultivohen, tregtohen, importohen, eksportohen, transportohen dhe tjetërsohen ose në çfarëdo mënyre të përvetësohen dhe preparohen;
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 97)

24. Çdo person është përgjegjës për mbrojtjen nga zhurma dhe zbatimin e rregullave të përcaktuara me politikat qendrore dhe lokale, duke përfshirë institucionet qendrore, njësitë lokale, personat fizik e juridik dhe qytetarët.

Zhurma e dëmshme për shëndetin e njeriut është çdo zhurmë e cila tejkalon vlerat kufitare të lejuara që përcaktohen me akt të veçantë normativ, shikuar nga aspekti kohor dhe nga vendi ku buron zhurma, në mesin ku njerëzit punojnë dhe jetojnë.
(Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, neni 2)

25. Nuk lejohet që niveli i zhurmës së cilës i ekspozohen njerëzit në mjediset ku jetojnë t'i tejkaloj kufijtë e lejuar; pengimin e personit të autorizuar në kryerjen e matjeve të zhurmës; që të përdoren makinat, mjetet transportuese, pajisjet dhe aparatet në qarkullim, respektivisht në përdorim, pa shënime mbi forcën e zërit; fillon kryerjen e veprimtarisë ose aktiviteteve të tjera, pa vendim të organit kompetent, me të cilin përcaktohet se janë kryer të gjitha masat për mbrojtje nga zhurma; që të shfrytëzohen burimet e zhurmës në vende të hapura, pa vendim të organit kompetent; kryhen punime, veprime dhe aktivitete tjera, me të cilat pengon qetësin dhe pushimin e njerëzve në hapësirë të mbyllur ose të hapur në vendet ku ata jetojnë; të mos ndërmerren masa nga rregullorja ose nga urdhërat për mbrojtje nga zhurma;
(Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, neni 25)

26. Mbrojtja nga zhurma aplikohet ditën, mbrëmjen dhe natën. Dita zgjat 12 orë dhe fillon nga ora 07:00 deri në 19:00, mbrëmja zgjat 3 orë dhe fillon nga ora 19:00 deri në ora 22:00, kurse nata zgjat 9 orë dhe fillon nga ora 22:00 deri në ora 07:00 në mëngjes. Gjatë natës, përkatësisht nga ora 22:00 deri në 07:00 ndalohet kryerja e punëve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera, që

shkaktojnë zhurmë e cila pengon qetësinë dhe pushimin e njerëzve, në vende të hapura ose të mbyllura. Sa i përket dëgjimit të zërimit të zilës ose pajisjeve elektroakustike në kohën e riteve fetare dhe festive nuk është i kufizuar, ndërsa gjatë ditëve të tjera lejohet gjatë periudhës 07:00 deri 22:00.

(Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, neni 5,6,16 dhe 17)

27.

Ndërtesa duhet të jetë e projektuar dhe e ndërtuar në mënyrë që zhurma të cilën e dëgjojnë njerëzit që banojnë në afërsi ose në ndërtesë, të jetë e atij intenziteti që nuk do ta rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për pushim dhe punë sipas Ligjit për Ndërtimin.

(Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, neni 11)

28.

Burimet e zhurmës të cilat nuk tejkalojnë nivelin e lejuar në mjedis, të cilat janë në përdorim të përkohshëm ose të cilat vendosen në vende të hapura mbi nivel të tokës, në mure ose mbi pullazë të ndërtesave, në objekte të lëvizshme ose të palëvizshme ose të cilat përdoren në ajër, duhet t'i përmbajnë shënimet mbi fuqinë dhe intenzitetin e zërit. Këto burime mund të përdoren me aprovimin e inspektoriatit për mjedis, ku në rast se burimi i zhurmës emiton nivel më të lartë të zhurmës se sa ai i lejuar, atëherë pronari i burimit të zhurmës i bartë shpenzimet e matjeve. Ndërsa nivel më të ulët të zhurmës se sa ai i lejuar, atëherë organi kompetent i bartë shpenzimet e matjeve.

(Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma, neni 14)

Kushdo që djeg lëndë të tjera, të ndryshme nga ato të përcaktuara në lejen e përdorimit të objektit, nga prodhuesi i pajisjes, të prodhimit dhe të tregtimit të lëndëve djegëse, apo që tejkalojnë parametrat e përcaktuar teknik ose me masat tekniko-organizative për vënien në përdorim të burimeve të ndotjes, dënohet;

(Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 8 dhe 38)

30.

Për ndërtimin e impianteve të reja dhe renovimin e impianteve ekzistuese, duhet të përdoren teknologjitë më të mira të mundshme;

(Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 8)

31.

Personi juridik ose fizik i cili prodhon, transporton, lëshon në qarkullim, shfrytëzon, përpunon, magazinon dhe deponon materiet e rrezikshme, është i detyruar që të evitoj rrezikun ndaj jetës dhe shëndetin e njeriut, ndotjen e mjedisit dhe ndërmarr masat mbrojtëse në rast të aksidenteve sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Të njëjtit janë të obliguar të mbajnë evidencën për llojet dhe sasinë e kimikateve të rrezikshme;

(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 47)

32.

Kushdo që ndërhyrë në natyrë duhet të sigurohet që në shkallë sa më të vogël ta dëmtoj natyrën, e pas mbarimit të ndërhyrjes është i detyruar që në zonën e ndikimit të ndërhyrjes të vendos gjendjen e njëjtë ose përafërsisht të njëjtë e cila ishte para ndërhyrjes gjegjësisht të bëjë përtëritjen e natyrës;

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 42 dhe 44)

33. Menaxhimi i mbeturinave organizohet në atë mënyrë që prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave të parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave për parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut në pajtim me këtë ligj. Komuna është e detyruar të siguroj largimin dhe përkujdesjen e mbeturinave të cilat janë hedhur në hapësira publike ose jashtë deponive të mbeturinave në territorin e saj.

(Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, neni 15 dhe 24)

34. Të gjithë shfrytëzuesit e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, janë të obliguar që gjatë shkarkimit të ujërave të shfrytëzuara, të mos shkaktojnë veprime të dëmshme në mjedisin rrethues dhe sferat tjera të mjedisit. Ndalohet, përveç me leje ujore, shkarkimi i masës nga hedhurinat e lëngëta industriale, bujqësore dhe ujërave të ndotura urbane si dhe vajrave të përdorura në kanalizim, në sistemin për kullim, në trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, në brigjet buzë lumit dhe tokave të lagëta. (Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 23 dhe 60)

35. Në zonat vërshuese ndalohet përdorimi i substancave organike dhe inorganike për plehërimin e tokës, spërkatjen e pemëve dhe mbrojtjen e bimëve pranë lumenjve, akumulimeve dhe brigjeve lumore, në largësi prej tridhjetë (30) metrash.

(Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 61)

36. Ndalohet larja e mjeteve lundruese, mjeteve motorike dhe pajisjeve tjera në ujërat sipërfaqësore dhe në brigje. (Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 62)

Ndalohet hudhja e substancave dhe mbeturinave të ngurta, të lëngëta dhe të gazta të cilat për shkak të vetive fizike, kimike dhe biologjike, rrezikojnë shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, florën dhe faunën ujore, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë objektet dhe pajisjet ujore. Personat juridikë dhe fizikë të cilët shkarkojnë, hedhin, depozitojnë substanca të rrezikshme dhe të dëmshme në ujëra, në brigje apo në zona të mbrojtura, janë të detyruar që të raportojnë rastin tek autoritetet kompetente.

(Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 63 dhe 64)

Ndalohet çfarëdo lloj i transportimit të substancave, materieve dhe mbeturinave të rrezikshme pranë akumulimeve dhe zonave ujore të mbrojtura përveç me leje të veçantë. (Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 63)

Pronari i një paluajtshmërie nuk mund të ndalojë daljen e gazrave, avujve, tymit, blozës, nxehtësisë, zhurmës, dridhjeve dhe ndikimeve të ngjashme që dalin nga një paluajtshmëri, përderisa ndikimet nuk cenojnë ose cenojnë jo qenësisht përdorimin e paluajtshmërisë. Një cenim i jo qenësishëm ekziston, nëse nuk janë tejkaluar vlerat kufizuese të parashikuara në ligje dhe në akte nënligjore.

(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Neni 82)

40. Një paluajtshmeri nuk guxon të mihet në atë mënyrë që sipërfaqja e paluajtshmerisë fqinje të humbë mbështetjen e nevojshme, përveçse kur pronari i saj paraprakisht është përkujdesur për një përforsim tjetër të nevojshëm.

(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Neni 91)

41. Pronari i një paluajtshmerie nuk guxon ta ndryshojë në dëm të fqinjëve rrjedhën e ujit ose sasinë dhe cilësinë e ujit të rrjedhshëm, e cila rrjedh pranë apo nëpër paluajtshmerinë e tij.

(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Neni 92)

04 E DREJTA NDAJ PRONËS

1. Çdo person gëzon të drejtën e pronës. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprium e pronës nëse ky ekspoprim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 46)

2. Kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksploatimin e të mirave me interes të veçantë për Republikën e Kosovës dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohen me ligj.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 122)

3. Nëse poseduesi i pronës privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, ka të drejtë të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta. Poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave si dhe mbrojtje gjyqësore nëse pritet që të hasë në pengesa të mëtutjeshme. (Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 113)

Çdo person mund të dëmtoj ose shkatërroj pasurinë e luajtshme që i takon ndonjë personi tjetër me qëllim të largimit nga vetvetja ose nga personi i tretë rrezikun e prishëm që rrjedhë nga kjo pasuri e luajtshme, përderisa dëmtimi ose shkatërrimi i kësaj pasurie të luajtshme ishte e domosdoshme për largimin e rrezikut. (Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 20)

Pronari ose bartësi i të drejtës së tokës në të cilën gjendet objekti speleologjik nuk guxon të rrezikoj ose dëmtoj objektin speleologjik, të mbyll hyrjen, të pengojë shfrytëzimin e tij për aq sa është e lejuar si dhe është i detyruar të mundësoj qasje dhe vizita në atë objekt vetëm për qëllime të lejuara me ligj. (Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 54)

Pronari ose bartësi i të drejtës në të mirat e natyrës ka autoritetin të aprovoj grumbullimin e bimëve, kërpudhave dhe pjesëve të tyre si dhe kapjen ose vrasjen e shtazëve të cilat i përkasin kategorisë të llojeve të egra të mbrojtura. (Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 90)

Pronari ose bartësi i të drejtës së tokës në të cilën janë gjetur mineralet, fosilet dhe shtresimet është i detyruar të lajmëroj Ministrinë në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e gjetjes, si dhe të ndërmer masat e duhura të mbrojtjes

nga shkatërrimi, dëmtimi ose vjedhja. I njëjti është i detyruar që të mundësojë hulumtimin e vendgjetjes në pajtim me vendimin e Ministrisë. Për shtresimet të cilat merr mineralet, shtresimet ose fosilet nga natyra të cilat nuk janë të shpallura të mbrojtura si vlera të natyrës.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, neni 110, 111, 112 dhe 137)

- 8.** Në qoftë se gjendet një send me vlerë të veçantë, i cili ka qëndruar gjatë i fshehur sa që nuk mund të gjendet pronari i tij, atëherë pronësia në atë send fitohet sipas kësaj ndarje, 1/3 për gjetësin, 1/3 për pronarin e sendit të paluajtshëm në të cilin ishte fshehur sendi dhe 1/3 i takon shtetit.

(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 34)

- 9.** Pronari i patundshmërisë i cili ka për qëllim me e shitë patundshmërinë brenda parkut kombëtar, parkut të natyrës, rezervatit strikt dhe zonës së veçantë dhe zonave të tjera të mbrojtura është i detyruar që më parë t'ia ofroj institucioneve sipas kriterëve të përcaktuara me ligj. Organi i administratës ose organi kompetent komunal është i detyruar që në kërkesën e pronarit të patundshmërisë në zonën e mbrojtur të cilën e ka shpallë Kuvendi ose Qeveria, sipas çmimit të tregut t'a blejë patundshmërinë ose të ofroj patundshmëri tjetër me vlerë të njëjtë. Në të kundërtën, nëse pronari shet patundshmërinë në zonën e mbrojtur tek një person juridik apo fizik tjetër, Republika e Kosovës ose komuna kanë të drejtë që me padi kundër shitësit dhe blerësit të kërkojnë anulimin e kontratës në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e të kuptuarit për lidhjen e asaj kontrate, por më së largu në afat prej pesë (5)

viteve nga dita e lidhjes së kontratës për shitblerje. (Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, neni 110, 111, 113 dhe 116)

- 10.** Personat e huaj juridik ose fizik nuk mund të fitojnë të drejtën e pronësisë së patundshmërive në rezervatin strikt, parkun kombëtar, zonën e veçantë, parkun e natyrës, monumentin e natyrës, peizazhin e mbrojtur dhe monumentin e arkitekturës së parqeve, përveç rasteve kur me kontrata ndërkombëtare nuk është caktuar ndryshe.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, neni 114)

- 11.** Në rastet kur është e domosdoshme që për shkak të zbatimit të mbrojtjes dhe ruajtjes të vlerave të mbrojtura të natyrës, konsiderohet se ekziston interesi i Republikës së Kosovës për shpronësim ose kufizim të pronësisë dhe të drejtave të tjera sendore në patundshmëritë në zonën e mbrojtur. Poashtu institucionet mund të kërkojnë eksproprium apo kufizim të të drejtave të pronarit, përkatësisht të poseduesit të tokave, ujit apo brigjeve në rast të përdorimit publik të ujërave ose brigjeve.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, neni 115; Ligji Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, neni 12)

- 12.** Pronari ose përdoruesi i ligjshëm i zonës së mbrojtur është i detyruar të lejoj qasje në vlerën e caktuar natyrore, duke pas parasysh qëllimin e mbrojtjes dhe rëndësinë e asaj vlere të natyrës për të përmbushur nevojat shkencore, arsimore, estetike, kulturore dhe rekreative sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara me vendim të ministrisë

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, neni 117)

13. Pronari ose përdoruesi i ligjshëm i zonës së mbrojtur mund të përkujdeset për vlerën e natyrës në zonën e mbrojtur, sipas kushteve të kontratës që rregullohen të drejtat dhe detyrimet reciproke nga autoriteti i cili administron me vlerën e mbrojtur të natyrës dhe pronarin ose përdoruesin e ligjshëm të patundshmërisë;
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, neni 132)

14. Pronarit ose poseduesit të tokës dhe të resurseve ujore mund t'i kufizohet shfrytëzimi i tyre me qëllim të mbrojtjes së ujërave, shfrytëzimit të përgjithshëm të ujit, pasurive tjera ujore të cilat kryhen për nevoja të interesit publik;
(Ligji Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, neni 9)

15. Pronari ose poseduesi i tokës duhet të lejoj kalimin apo përdorimin publik apo të rezervuar, nëse veprime të tilla nuk i shkaktojnë dëm, me qëllim të ndërtimit dhe instalimit të pajisjeve të infrastrukturës publike; ndërtimit të pajisjeve për pasuritë artificiale, të parapara me këtë ligj dhe aktet nënligjore, të dalura nga ky ligj; masave të zbatuara për përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike dhe biologjike, të ujërave sipërfaqësore; masave të zbatuara për mbrojtje të natyrës; ndërtimit të pajisjeve të nevojshme; ndërtimit të objekteve për përdorim të ujërave; mbrojtjes nga përmytjet; shfrytëzimit të banjove natyrore; dhe vendosjes së pajisjeve të caktuara, për siguri publike dhe shpëtim; të kërkimeve ujore, për nevojat e furnizimit me ujë të pijes, vrojtimet për interes publik të ujërave. Kryesi i punëve është i detyruar që pas kryerjes së punëve, tokën dhe objektet, t'i kthej në gjendjen e mëparshme.
(Ligji Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, neni 10 dhe 11)

Pronari ose poseduesi i tokës duhet të lejoj kalimin nëse paluajtshmëria fqinje nuk ka asnjë qasje tjetër në rrugë ose nëse kjo është e lidhur me një rrugë më të gjatë dhe nëse dobia për paluajtshmërinë, në favor të së cilës lejohet kalimi, është më e madhe se sa dëmi për paluajtshmërinë, nëpër të cilin duhet kaluar. Drejtimi i kalimit të domosdoshëm duhet të caktohet në një mënyrë që i siguron kalimin më të përshtatshëm fqinji që e kërkon kalimin dhe më së paku e pengon fqinji i cili e lejon kalimin.

(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 86)

Pronarët e paluajtshmërive fqinjë janë të detyruar që ti marrin parasysh të drejtat dhe interesat e fqinjëve të tyre dhe të drejtat e tyre t'i ushtrojnë ashtu që të mos cenohen apo dëmtohen të drejtat e të tjerëve. Kjo vlen edhe për raportin ndërmjet pronarit të një paluajtshmërie dhe pronarit të ndërtesës, e cila gjendet mbi këtë paluajtshmëri, nëse sipas natyrës së tyre janë të zbatueshme edhe në këtë raport.

(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 78)

Pronari ose poseduesi i tokës ka të drejtën që të prejë ose në ndonjë mënyrë tjetër t'i mënjanojë degët që rriten përtej kufirit të paluajtshmërisë fqinjë, nëse ato pengojnë dhe nëse pronari i pemës këtë nuk e bënë në afatin e arsyeshëm përkundër kërkesës së fqiu. Një e drejtë e tillë nuk i takon pronarit, nëse kufiri mes paluajtshmërive gjendet në një pyll. Ndërsa sa i përket rrënjëve që rriten nga një paluajtshmëri fqinje, pronari i paluajtshmërisë tjetër mund t'i shkurtojë vetëm atëherë, kur rrënjët shkatërrojnë apo rrezikojnë strukturën

e një ndërtese ose të një kulture të bimëve të mbjell në paluajtshmërinë e tij.

(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 84)

- 19.** Nëse ekziston një rrezik serioz që një ndërtesë apo një pjesë e saj të shembet dhe e rrezikon paluajtshmërinë fqinje ose paluajtshmërinë që e rrethon, pronari i paluajtshmërisë që rrezikohet mund të kërkojë nga pronari i ndërtesës që t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e rrezikut.
(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 89)

- 20.** Nëse pronari i një paluajtshmërie gjatë ndërtimit të një ndërtese ka ndërtuar përtej kufirit, pronari i pronës fqinji mund të kërkojë nga pronari i paluajtshmërisë që pronësia në ndërtesë të ndahet në vijën e kufirit, të mënjanoj pjesën e ndërtesës e cila gjendet në paluajtshmërinë e fqit që kundërshton ose që ndërtuesi të blejë pjesën e paluajtshmërisë e cila është mbuluar me ndërtim.
(Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 90)

05 E DREJTA E INFORMIMIT DHE KOMUNIKIMIT

1. Çdo person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 41)

2. Ministria, institucionet qendrore, komunat, organizatat e autorizuara dhe të tjera, janë të detyruara që rregullisht, dhe me kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive ta informojnë publikun për gjendjen e mjedisit, respektivisht për dukuritë të cilat janë duke u përcjellë në kuadër të monitorimit të emisionit dhe cilësisë të mjedisit, si dhe për masat paralajmëruese ose të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin dhe jetën e njeriut, në përputhje me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 54)

3. Çdo person gëzon të drejtën e qasjes në të dhënat rreth mbrojtjes së mjedisit përmes kërkesës në institucionet përgjegjëse, sipas procedurës së rregulluar me ligj. Kërkesa për dhënie të informacioneve të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit mund të refuzohet nëse publikimi i këtyre informacioneve mund të ndikon në besueshmërinë e punës së

institucioneve qendrore dhe lokale kur është paraparë me ligj; ndikon në raportet ndërkombëtare, mbrojtjen e vendit dhe sigurimin publik; ndikon në punën e organeve gjyqësore; besueshmërinë e të dhënave komerciale dhe industriale kur të dhënat e tilla janë paraparë të mbrohen me ligj, përveç informacioneve për emisionin i cili e rrezikon mjedisin; të drejtat e pronësisë intelektuale; besueshmërinë e të dhënave personale, respektivisht dosjeve kur ato janë paraparë që të mbrohen me ligj; interesat e palëve të treta të cilat posedojnë informacione, që nuk janë të detyruar t'i ofrojnë, respektivisht nuk pajtohen që ato të publikohen.

(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 56)

Publiku duhet të ketë qasje në evidencën e të dhënave për gjendjen e mbrojtjes së natyrës dhe udhëzime për formën se si duhet vepruar për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës në rast të dëmtimit. Në rast të çfarëdo kërcënimi për natyrën dhe shëndetin e popullatës, publiku informohet për masat e ndërmarra dhe veprimet e duhura me qëllim të pengimit ose zbutjes të dëmeve të cilat mund të dalin nga ai rrezik. Në rast të kërkesave specifike, institucionet duhet kërkuarve t'iu ofrojnë informacione për gjendjen e mbrojtjes së natyrës, për kryerjen e punëve të mbrojtjes së natyrës dhe t'iu mundësojnë qasje në dokumentacionin përkatës. Informacioni për gjendjen e

e mbrojtjes së natyrës sipas parimit jepet në formë të shkruar.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, neni 148 dhe 149)

- 5.** Publiku duhet të ketë qasje në raportin një vjeçar për gjendjen e mjedisit, i cili hartohet nga ministria dhe duhet të përmbaj të dhëna mbi gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm; ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës; gjendjen e mjedisit të rrezikuar; zbatimin e Strategjisë, Planit të veprimit dhe planeve sanuese për mjedis; masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, sukseset nga masat e ndërmarra dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik; mënyrën e menaxhimit të resurseve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit; analizat për funksionimin e institucioneve, autoriteteve dhe subjekteve të tjerë për mbrojtjen e mjedisit; financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit.
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 25)

- 6.** Publiku ka të drejtë të qasjes në kadastrin e ndotësve, i cili administrohet nga ministria dhe përmban të dhënat rreth shkarkimeve dhe transferimeve të ndotësve në mjedis, ujin e përdorur të energjisë dhe resurse natyrore në përputhje me ligjin. Përveq matjeve që zhvillojnë institucionet, ndotësi është i detyruar që me shpenzime të veta t'ia dorëzoj Ministrisë të dhënat e parapara në mënyrën dhe afatin e përcaktuar me ligj.
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 53; (Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 22)

- 7.** Publiku duhet të ketë qasje në informatat e përditësuara për përqëndrimin e materieve ndotëse në

ajër, të cilat monitorohen përmes sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit që rregullohet me ligj. Në rastet e rrezikut të tejkalimit të pragut të alarmimit sa i përket cilësisë së ajrit apo smogut institucionet informojnë publikun rreth masave paralajmëru-ese përmes sistemit special paralajmëruar që zhvillon ministria, sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Në rastet kur operatorë të caktuar shkaktajnë ndotjen e ajrit në mënyrë të theksuar, duhet të ndërmerren masat emergjente për zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe duhet të njoftojnë ndër të tjerë edhe publikun.

(Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 24, 25 dhe 33)

- 8.** Publiku duhet të ketë qasje në shënimet e përcaktuara rreth kemikateve në Kosovë, sipas procedurës dhe kushteve të përcaktuara me ligj.
(Ligji Nr. 04/L-197 për Kimikate, neni 68)

- 9.** Publiku duhet të ketë qasje në Inventarin e Produkteve Biocide dhe Substancave Aktive Biocide i cili përmban listën e produkteve biocide të notifikuara dhe kornizën kohore të qëndrimit të tyre në treg. Poashtu ministria për çdo vit bënë publike në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Listën e PB të lejuara, dhe publikon ndryshimet dhe plotësimet e regjistrave dhe shënimeve.
(Ligji Nr. 03/L-119 për Produktet Biocide, neni 32 dhe 44)

- 10.** Publiku duhet të ketë qasje në raportet e personave juridik dhe fizik për shfrytëzimin e resurseve natyrore, të cilat duhet t'i pranoj dhe publikoj ministria.
(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 11)

- 11.** Publiku duhet të ketë qasje në sistemin informativ uJOR, i cili administrohet nga ministria dhe përfshin masat dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me regjistrimin, transferimin, mbrojtjen, shfrytëzimin e të dhënave si dhe çështjet e tjera me rëndësi për administrim me ujëra. Sistemi informativ uJOR përfshin të dhënat për sasinë dhe cilësinë e ujërave; protokollin uJOR dhe kadastrat e sistemit uJOR; protokollin e të gjitha lejeve; regjistrin e substancave të shkarkuara nga bartësi i lejes uJore; masat për rehabilitimin dhe programet për mbrojtjen e ujërave; incidentet e dëmtimit të ujërave dhe aksidentet mjedisore; regjistrin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme, në resurset uJore; aktivitetet që janë të rrezikshme për shëndetin publik dhe mjedisin; e ndikimeve të materieve të rrezikshme; dhe regjistrin më të dhënat e ndërtimeve, instalimeve apo deponive ekzistuese që janë të rrezikshme; raportim për gjendjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Të gjithë personat dhe institucionet, janë të detyruara t'i ofrojnë të dhëna për ujërat Ministrisë dhe autoriteteve kompetente për ujëra. (Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 81)
- 12.** Publiku duhet të informohet nga ministria ose komuna përkatëse për shpalljen e gjendjes së mjedisit të rrezikuar, në rast të aksidentit mjedisor që mund të shkaktojnë rrezik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. (Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 48)
- 13.** Publiku duhet të informohet në rast të prishjeve të pajisjeve ose instalimeve për mbrojtjen e mjedisit, gjë që shkakton tejkalimin e vlerave të lejuara të emisionit të ndotjes nga personat përgjegjës. (Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 48)
- 14.** Publiku duhet të ketë qasje në planin e miratuar të masave të rehabilitimit që hartohet në rastet e aksidentit mjedisor. (Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 35)
- 15.** Në rast të rrezikut nga erozioni dhe rrëketë, publiku duhet të informohet menjëherë për masat e ndërmarra dhe të këshilloj çfarë masash të ndërmerren me qëllim që të mbrohet jeta, shëndeti dhe pasuria e njerëzve. (Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 57)
- 16.** Ministria duhet të informoj publikun dhe autoritetet përkatëse për rreziqet që mund të rrjedhin nga përdorimi i substancave dhe përzierjeve të rrezikshme dhe të rekomandojë marrjen e masave të nevojshme për zvogëlimin e rrezikut. Ministria nxjerr dhe publikon udhëzime teknike për nevojat e informimit të publikut dhe publikon regjistrat e substancave dhe përzierjeve përkitazi me ligjin. (Ligji Nr. 04/L-197 për Kimikate, neni 15)
- 17.** Publiku duhet të ketë qasje në shënimet nga Regjistri i vlerave të mbrojtura të natyrës, përveç nëse përcaktohet që shënimet janë fshehtësi për të ruajtur atë. Ky regjistër administrohet nga ministria, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. (Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, neni 28)

18. 18. Publiku duhet të ketë qasje në Inventarin e të gjithë përbërësve të larmisë biologjike, gjeologjike e peizazhore - llojet, tipat e vendbanimeve, gjeolokaliteteve dhe tipave të peizazheve, paraqitjen hartografike të llojeve të kërcënuara, gjeolokaliteteve dhe tipat e vendbanimeve si dhe plotësimin e përhershëm dhe me kohë të tyre.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 20)

19. Ministria, duhet të sigurohet se publiku është informuar për projektin e caktuar përmes së paku një gazete lokale ditore e cila del në lokalitetin i cili do të jetë i përfshirë nga ndikimi i projektit të planifikuar, si edhe me anë të mjeteve elektronike të informimit. Poashtu, ministria është e obliguar që palëve të interesuara dhe publikut t’iu vë në dispozicion dokumentacionin për procedurën e bërë të VNM-së, në bazë të kërkesës së paraqitur në formë të shkruar, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, neni 28 dhe 31)



06 E DREJTA E PJESEMARRJES NË VENDIMARRJE

1.1. Çdo person gëzon të drejtën e garantuar për pjesëmarrje në aktivitete publike dhe ndikim në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike përfshirë ato që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton, sipas kushteve të përcaktuara me ligjet përkatëse.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 45 dhe 52)

2. Publiku ka të drejtë të pjesëmarrjes në procesin e hartimit dhe miratimit të strategjive dhe planeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit, duke përfshirë planin hapësinor të Kosovës, planin zhvillimor komunal, hartën zonale të Kosovës dhe atë komunale, strategjinë shtetërore të ujërave dhe planit për menaxhimin e pellgut lumor, ..., sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, neni ??; Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 81 Dhe 84 ...)

3. Publiku ka të drejtë të ofrimit të sugjerimeve dhe komenteve rreth planit të masave të rehabilitimit, në rastet e aksidenteve mjedisore sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 34)

4. Publiku ka të drejtë të ofrimit të sugjerimeve dhe komenteve në aktin e propozuar për shpalljen e zonës së mbrojtur dhe bazën profesionale me

dokumentacionin hartografik, përkatësisht parqeve kombëtare, parqeve të natyrës, rezervatit strikt dhe zonën e veçantë të cilën e udhëheqë niveli qendror dhe monumentin e natyrës, peizazhin e mbrojtur dhe monumentin e arkitekturës së parqeve të cilën e udhëheqë niveli lokal sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 20)

Publiku ka të drejtë të pjesëmarrjes në procesin e hartimit të akteve për shpalljen e vlerave të mbrojtura të natyrës, planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura dhe planeve për shfrytëzimin e të mirave të natyrës si dhe dispozitave të përgjithshme ligjore të zbatueshme dhe të detyrueshme dhe dokumenteve në fushën e mbrojtjes së natyrës sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 151)

Publiku ka të drejtë të ofrimit të sugjerimeve dhe komenteve në raportin e vlerësimit strategjik mjedisor në bashkërendim me planin apo programin për të cilin hartohet vlerësimi sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, neni 8 dhe 9)

7.Publiku ka të drejtë të ofrimit të sugjerimeve dhe komenteve në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe propozim-vendimin për pëlqim mjedisor, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, 21 Dhe 22)

8.Publiku ka të drejtë të angazhimit aktiv në procedurën e lëshimit të lejes ujore dhe lejes integruese sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 57 dhe 84)

07 E DREJTA E QASJES NË DREJTËSI DHE KOMPENSIM

1. Çdo person gëzon të drejtën e garantuar të lirisë dhe sigurisë. Një gjë e tillë mund të privohet vetëm në rastet kur gjykata kompetente me vendim shpall dënimin me burgim për kryerjen e veprës penale apo kur ky veprim konsiderohet i domosdoshëm për parandalimin e kryerjes së veprave penale, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29)

2. Çdo person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32)

3. Çdo person gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur. Poashtu, i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31 dhe 54)

4. Çdo person që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit dhe të drejtën e mos deklaramit dhe mbrojtjes sipas zgjedhjes së vet, në gjuhën që ajo/ai e kupton sipas kushteve të përcaktuara

me ligj. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhë të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 29 dhe 30)

5. Çdo person gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbente rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31)

6. Çdo person i akuzuar për vepër penale, konsiderohet i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31)

7. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit. Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës apo të jetë në disproporcion me veprën penale. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të rasteve kur kushtet në kuadër të ligjit të ri janë më të favorshme për kryesin e veprës.

(Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 33)

8. Askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një vepër nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si vepër penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal. Përkufizimi i një veprë penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale.

(Kodi Penal I Republikës Së Kosovës Kodi Nr. 06/L-074, neni 2)

9. Çdo person i cili konsideron se kërkesa e tij për informacion është neglizhuar ose pa të drejtë është refuzuar ka të

drejtë në mbrojtjen e të drejtës së tij para gjykatës ose organeve tjera kompetente.

(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 150)

10.

Çdo palë e interesuar, përfshirë organizatat jo-qeveritare për mbrojtjen e mjedisit, në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vendimit të pëlqimit mjedisor për projekte të caktuara, ka të drejtë të qasjes në shqyrtimin e procedurave para gjykatës në kundërshtimin apo ligjshmërinë procedurale të vendimeve, akteve ose mos nxjerrjes së aktit që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e publikut sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Çdo procedurë e tillë duhet të jetë e barabartë, e drejtë, në kohë dhe jo aq e shtrenjtë sa të pengoj ushtrimin e saj.

(Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, neni 24)

11. Çdo person i cili pëson dëm mjedisor ka të drejtë në kompensim. Kërkesa për kompensimin e dëmit mund ti parashtrahet drejtpërdrejtë ndotësit ose siguruesit të tij, respektivisht garantuesit financiar të ndotësit tek i cili ka ndodh aksidenti, nëse një sigurues, respektivisht garantues financiar i tillë ekziston. Nëse më shumë ndotës janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar në mjedis, dhe nuk mund të përcaktohet saktësisht përgjegjësia e secilit ndotës, ata i bartin shpenzimet në mënyrë solidare, dhe veç e veç, sipas procedurës dhe kushteve të përcaktuara me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 71)

- 12.** Pronari ose bartësi i të drejtës në tokën në të cilën gjendet objekti speleologjik për kufizimet e shkaktuara nga shfrytëzimi i hapur i objektit speleologjik sipas kushteve të përcaktuara me ligj, ka të drejtën e përparësisë në ndarjen e koncesionit ose të drejtën e kompensimit lartësia e të cilit përcaktohet me institucionin përkatës.
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 54)
- 13.** Çdo person juridik ose fizik i cili për shkak të kufizimeve ose ndalesave të përcaktuara me ligj ose në bazë të aktit për mbrojtje, dukshëm i janë keqësuar kushtet ekzistuese për fitimin e të hyrave dhe nuk ka mundësi të kompensohet me veprimtarinë e lejuar në suaza të regjimit të mbrojtjes në zonën e mbrojtur, ka të drejtë të kompensimit në lartësinë e përcaktuar me marrëveshjen me institucionin përkatës.
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 117)
- 14.** Çdo person juridik apo fizik që pëson dëm ekonomik apo dëm tjetër nga llojet e shtazëve strikt të mbrojtura, i cili ka ndërmarr të gjitha masat e mbrojtjes së pronës të përcaktuara me ligj si rrethoja efikase, ruajtja e të mirës së caktuar dhe ndjekjen e llojeve strikt të mbrojtura të shtazëve, ka të drejtë të kompensimit në lartësinë e përcaktuar nga eksperti sipas kriterëve për llogaritjen e dëmit të përcaktuara me ligj. Nëse personi juridik ose fizik fillon veprimtarinë ose kryerjen e punëve në hapësirën e cila është vendbanim natyror i llojit të egër strikt të mbrojtur dhe në të cilin ajo jeton dhe ekziston rreziku i parashikuar i dëmit nga lloji strikt i mbrojtur, zvogëlohet lartësia e kompensimit për rrezikun e paraparë.
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 119, 120 dhe 121)
- 15.** Pronari ose përdoruesi i ligjshëm i zonës së mbrojtur ka të drejtë të kompensimit, në rast të kufizimeve të shkaktuara nga qasja e hapur në vlerën e caktuar natyrore sipas kushteve të përcaktuara me ligj, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e vlerës së natyrës dhe përmbushjen e nevojave shkencore, arsimore, estetike, kulturore dhe rekreative sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara me vendim të ministrive.
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 130)
- 16.** Pronari ose përdoruesi i ligjshëm i zonës së mbrojtur ka të drejtë të kompenzimit, në rast të kufizimeve në përdorimin saj.
(Ligji Nr. 03/L-233 Ligjin për Mbrojtjen e Natyres, neni 131)
- 17.** Pronari ose poseduesi i ujërave dhe resurseve ujore ka të drejtë të kompensimit për dëmin e zakonshëm që shkaktohet nga kalimet në hapësirat fizike dhe ujëra me qëllim të ndërtimit dhe instalimit të pajisjeve të infrastrukturës publike; ndërtimit të pajisjeve për pasuritë artificiale të përcaktuara me ligj; masave të zbatuara për përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike dhe biologjike të ujërave sipërfaqësore; masave të zbatuara për mbrojtje të natyrës; ndërtimit të objekteve për përdorim të ujërve; kërkimeve ujore; vrojtimeve për interes publik të ujërave; mbrojtjes nga përmytjet; shfrytëzimit të banjove natyrore; dhe vendosjes së pajisjeve të caktuara, për siguri publike dhe shpëtim.
(Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 10 dhe 11)

18. Pronari ose poseduesi i ujërave dhe resurseve ujore ka të drejtë të kompensimit për dëmin e shkaktuar nga persona juridik dhe fizikë nga shkarkimi, hedhja, depozitimi i substancave të rrezikshme dhe të dëmshme në ujëra, në brigje apo në zona të mbrojtura. Veprime të tilla duhet të raportohen tek autoritetet kompetente, ndërsa kompensimi bëhet nga personat juridik dhe fizik që ka shkaktuar dëmin.

(Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 11)

19. Pronari apo bartësi i të drejtës ndaj patundshmërisë ka të drejtë të kompensimit me shpërblim periodik për përdorimin e pronës për qasje në patundshmërinë fqinje me qëllim të kryerjes së punëve apo vendosjen e lidhjeve për furnizim kur qasja nuk është e mundur në ndonjë formë tjetër.

(Ligji Nr. 03/L-154 Për Pronësinë Dhe Të Drejtat Tjera Sendore, neni 86)

20. Pronari apo bartësi i të drejtës ndaj patundshmërisë ka të drejtë rente në rastet kur fqinji ka ndërtuar përtej kufirit, veprim i cili është kundërshtuar me shkrim nga i pari, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

(Ligji Nr. 03/L-154 Për Pronësinë Dhe Të Drejtat Tjera Sendore, neni 86)

Për EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqërjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: **1.** Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, **2.** Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe **3.** Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente:

1. Gjithëpërfshirjen, **2.** Qëndrueshmërinë, dhe **3.** Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

- 1. Paanshmëria** - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
- 2. Aktivizmi** - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyer përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
- 3. Orientimi drejt rezultateve** - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe
- 4. Komuniteti bazë e veprimit** - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

www.ecmandryshe.org